

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“ONE PAZAR” sh.p.k

Tiranë, më datë 07/11/2024

## NENI 1

Shoqëria Tregtare “ONE PAZAR” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

## NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “ONE PAZAR” sh.p.k.

## NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme: Ndërtimin dhe operimin e platformarve kompiuterike, importimin dhe tregtimin fizik dhe nëpërmjet platformave kompiuterike.

## NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" , Twin Towers, Toëer B, kati 5, pranë BLC, Tiranë.

## NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në dy (2) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Ilir Qafa, lindur në Berat, më 09/06/1978, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033276346, zotëron 25% të shoqërisë, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (25.000) lekë.
2. Rexhion Qafa, lindur në Berat më , shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. I60103038C, zotëron 25% të shoqërisë, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (25.000) lekë.



AKT THEMELIMI “ONE PAZAR” shpk

3. Armir Jangulli, lindur në Godvi, Bulqizë më 12.09.1996, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.038961234 zotëron 50% të shoqërisë, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (50.000) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

### **NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

### **NENI 7 - ORGANET DREJTUESE**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Ilir Qafa, shtetas Shqiptar, i Lindur në Berat, më 09.06.1978, me nr. personal H80609066H, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë


pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera

  
AKT THEMELIMI “ONE PAZAR” shpk

dhe  
të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE


Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.


**ORTAKU**

Ilir Qafa

  
(emer, mbiemer, firme)


**ORTAKU**


Rexhion Qafa

  
(emer, mbiemer, firme)

**ORTAKU**

Armir Jangulli

  
(emer, mbiemer, firme)

  
2024.